



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të përcaktuara me nenin 63.4 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë dhe me nenin 4.6 të Rregullës së KQZ nr. 01/2013 mbi Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike dhe vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa nr. 71/2020, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me datë 29.10.2020, merr këtë:

VENDIM

Për regjistrimin e Partisë Politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi – YTHP

- I. Regjistrohet Partia Politike “Yenilikçi Türk Hareket Partisi” me akronim YTHP, me kryetar z. Ertan Simitçi.
- II. Partia Politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi – YTHP, i ka përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 12 të Ligjit Nr.03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe obligimet e përcaktuara me nenet 3 dhe 4 të Rregullës zgjedhore 01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- III. Partia Politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi – YTHP, obligohet që brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të mbajë Kuvendin në bazë nenit 15 të Rregullës nr.01/2013 Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike.
- IV. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta përgatit certifikatën e regjistrimit dhe ta regjistroj Partinë Politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi – YTHP në Regjistrin e Partive Politike të Kosovës.
- V. Obligohet Zyra për Regjistrim të Partive Politike dhe Certifikim që ta njoftoj partinë politike Yenilikçi Türk Hareket Partisi – YTHP, për marrjen e këtij Vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Valdete Daka, Kryetare
Republika e Kosovës
Prishtinë
Prishtina
CENTRALNA IZBORNA KOMISIJA

Këshillë juridike: Brenda 24 orëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të gjitha palët që kanë interes juridik kanë të drejtë ankese në Panelin Zgjedhore për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP.